

nr 124 Prot

01.07.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr. 5154 Prot.

Gjirokastrë, më 01.07.2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 91, datë 01/07/2020

PËR

**NDRYSHIMIN E EMRIT TË AKSIONARIT TË SHOQËRISË "TRAJTIMI I
STUDENTËVE"SH.A. GJIROKASTËR**

Sot në datën 25.6.2020, unë Flamur Golemi me detyrë Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë, në cilësinë e titullarit të aksionarit që zotëron 100% të pronësisë të aksioneve të shoqërisë aksionare shtetërore vendore "Trajtimi i Studentëve"sh.a. Gjirokastrë,

KONSTATOVA

Me VKM-në Nr.365, datë 6.5.2020, është vendosur transferimi i pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve"sh.a. Gjirokastrë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare në internet rezulton, se VKM-ja e përshkruar si më sipër ka hyrë në fuqi, pasi është botuar në fletoren zyrtare Nr.84, datë 11.5.2020.

Në vijim të realizimit të procedurës të kalimit të pronësisë së 100% të aksioneve të Bashkia Gjirokastrë, Ministria e Financave me Urdhërin Nr.125, Nr.8277/1Prot, datë 20.5.2020, ndërmjet të tjerave ka urdhëruar edhe përgatitjen e akteve përkatëse për ndryshimin e emrit të aksionarit në statutin e shoqërisë "Trajtimi i Studentëve"sh.a. Gjirokastrë.

Në këto kushte, në bazë dhe zbatim, të Neneve 117 e 119, të pikës 2, të Nenit 135, të pikës 1, të Nenit 136 dhe të pikës 1, të Nenit 145, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të VKM-së Nr.365, datë 6.5.2020, "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve"sh.a. Gjirokastrë, nga ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë" dhe Urdhërit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Nr.125, datë 20.5.2020, "Mbi zbatimin e VKM-së Nr.365, datë 6.5.2020, "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve"sh.a. Gjirokastrë, nga ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë",

VENDOSA

1. Statuti i shoqërisë "Trajtimi i Studentëve"sh.a. Gjirokastrë, të ndryshohet për aq sa është e nevojshme, duke pasqyruar në mënyrë të qartë ndryshimin e aksionarit, që në këtë rast është Bashkia Gjirokastrë.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi, Neni 24 i statutit të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë ndryshon me këtë përmbajtje, "Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë përbëhet nga zotëruesi i 100% të aksioneve të saj që është Bashkia Gjirokastrë e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë. Të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të parashikuara nga Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që nuk janë parashikuar në këtë statut, ushtrohen nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë".

3. Miratimin dhe depozitimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të statutit të ndryshuar të shoqërisë dhe pasqyrimin në regjistrin tregtar të aksionarit Bashkia Gjirokastrë si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë, me Nipt-K43128662E.
4. Administratori i shoqërisë pasqyron në regjistrin e posaçëm emrin e aksionarit të ri, që zotëron pronësinë mbi 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
FLAMUR GOLEMI





BASHKIA GJIROKASTËR

Nr. 5168 Prot.

Gjirokastrë, më 01.07.2020

Lënda: Për kryerjen e veprimeve pranë QKB-së, për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse të të dhënave të regjistrit tregtar për shoqërinë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë.

**Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë
"18-Shtatori", GJIROKASTËR**

Bashkëlidhur dërgojmë statutin e miratuar të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë sipas shkresës Nr.5156Prot, datë 01.07.2020, statut në të cilin janë pasqyruar ndryshimet e aksionarit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë, së bashku me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme Nr.91, datë 01.07.2020, të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë.

Administratoria e shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme në lidhje me depozitim të pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të statutit të ndryshuar të shoqërisë dhe pasqyrimin në regjistrin tregtar të aksionarit Bashkia Gjirokastrë si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë, me Nipt-K43128662E, brenda një dite pune nga moment i administrimit të dokumentacionit si më sipër.

KRYETARI

Flamur GOLEMI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI PËRGJITHSHËM**



Nr 123. Prot.
Dl. 21.07.2020.



BASHKIA GJIROKASTËR

Nr. 556 Prot.

Gjirokastrë, më 21.07.2020

Lënda: Për miratimin e statutit të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë

**Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë
"18-Shtatori", GJIROKASTËR**

Në përfundim të shqyrtimit të ndryshimit të statutit të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë, në zbatim të të VKM-së Nr.365, datë 6.5.2020, "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i studentëve" sh.a. Gjirokastrë, nga ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë", Bashkia Gjirokastrë në cilësinë e pronarit të 100% të aksioneve të kësaj shoqërie konstaton se këto ndryshime janë në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në këto kushte, bazuar në Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" miratojmë ndryshimet në statutin e shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë, me Nipt-K43128662E.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 43, të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", administratoria e shoqërisë, të kryejë veprimet përkatëse pranë Q.K.B.-së në lidhje me depozitimin e statutit të ndryshuar të shoqërisë dhe pasqyrimin në regjistrin tregtar të aksionarit Bashkia Gjirokastrë si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" sh.a. Gjirokastrë, me Nipt-K43128662E, brenda një dite pune nga moment i marrjes së njoftimit.

KRYETARI
Flamur GOLEMI

STATUTI I SHOQËRISË ANONIME
“TRAJTIMI I STUDENTËVE GJIROKASTËR”

Në këtë statut termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- “Ligji” është Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është statuti i shoqërisë aksionare “Trajtimi i Studentëve”sh.a. Gjirokastrë;

Kreu I

Themelimi, emri, objekti, kohëzgjatja, selia, aksionari dhe adresa e faqes në internet e shoqërisë

Neni 1

Data e themelimit dhe emri i shoqërisë

1. Shoqëria është krijuar sipas Vendimit Nr.33948, datë 09.09.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Emri i shoqërisë është “Trajtimi i Studentëve”sh.a. Gjirokastrë, regjistruar me Nipt-K43126662E.

Neni 2

Objekti i aktivitetit të shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është, trajtimi i studentëve të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë me, akomodim dhe shërbime të tjera, në pëpruthje me legjislacionin në fuqi duke kryer cdo operacion tregtar dhe financiar të nevojshëm, që lidhet drejteperdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë dhe aksionari

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.
2. Bazuar në VKM-në Nr.365, datë 6.5.2020, “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve”sh.a. Gjirokastrë, nga ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Gjirokastrë”, Bashkia Gjirokastrë është aksionari i vetëm i shoqërisë duke zotëruar 100% të aksioneve të saj.

Neni 4:

Selia dhe adresa e postës elektronike

1. Selia kryesore e Shoqërisë është në lagjen “18-Shtatori”, Gjirokastrë.
2. Adresa e postës elektronike është tsshagi@yahoo.com dhe numri i telefonit është +35584263896.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5

Vlera e kapitalit të regjistruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 727.244.000 lekë i ndare ne 727.244 aksione me vlerë nominale 1000(njëmijë) lekë për çdo aksion, që zotërohen në masën 100% nga aksionari Bashkia Gjirokastrë.

Kreu III

Organet drejtuese të Shoqërisë

Organet drejtuese të Shoqërisë janë përkatësisht si më poshtë:

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë;
- Administratori/ët e Shoqërisë;
- Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë;

Neni 6

Emërimi i Administratorëve

1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare bazuar, në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 135, në nenin 158 dhe në pikën 2, të nenit 167, të Ligjit. Emërimi i administratorëve bëhet me akt individual emërimi pasi të jetë bërë miratimi me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë administratorët nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të caktohen si Administratorë.
3. Në emërimin e administratorëve respektohen të gjithë kufizimet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 158, të Ligjit.

Neni 7

Kompetencat e Administratorëve

1. Administratorët kryejnë të gjithë veprimet e administrimit të veprimtarisë dhe politikave tregtare të Shoqërisë. Shoqëria përfaqësohet nga administratorët të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me përcaktimet e, shkronjav "a", "gj" "h" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154, pikave 3 e 5 të nenit 158 dhe pikës 2, të nenit 167 të Ligjit.
2. Detyrat e Këshillit Mbikqyrës, të përcaktuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 dhe pikës 1 të nenit 167, të Ligjit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.
3. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit Mbikqyrës nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 8:

Përfundimi i marrëdhënies së Administratorëve

Marrëdhënia e administratorëve me Shoqërinë përfundon në rastet si më poshtë:

1. Personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme, sipas shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 135 dhe pikës 2, të nenit 167, të Ligjit;
2. Personi ndodhet në gjendje pa aftësie paguese;

3. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
5. Ka munguar për një periudhë kohore më të gjatë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikqyrës, në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe për këtë arsye Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Këshillit Mbikqyrës, ka vendosur shkarkimin e tij;

Neni 9

Kufizimet në Votimin e Administratorëve

1. Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje me subjekte juridik apo fizik, si dhe nuk do të votojnë për çështje në mbledhjen e Administratorëve, nëse kanë direkt ose indirekt, një interes apo detyrim material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, sipas nenit 13 të Ligjit, deri në momentin kur të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës në mënyrë unanime vendosin që:
 - Të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes përkatëse;
 - Të autorizojnë votimin për çështjen përkatëse;
2. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar dhe për cdo rast zbatohen parashikimet e pikave 2 dhe 5, të nenit 13, të Ligjit.
3. Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje, në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
4. Në rast se në mbledhjen e Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtarit të tij, çështja mund t'i drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 10

Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të veçantë të mbahen procesverbalet në lidhje me:

1. Të gjithë takimet e kryera nga Administratorët;
2. Të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve të aksioneve të klasave të ndryshme ose mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, ku kanë marrë pjesë sipas rastit edhe administratorët;

Neni 11

Këshilli Mbikqyrës, emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Asambleja e Përgjithshme emëron anëtarë të Këshillit Mbikqyrës persona fizik, në përputhje me VKM-në Nr.570, datë 3.10.2018, "Për këshillat mbikqyrës të shoqërive aksionare shtetërore", si dhe duke respektuar kërkesat e e shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 135, të pikës 2, të nenit 155 dhe pikës 4, të nenit 167, të Ligjit. Emërimet bëhen me akt individual emërimi, pasi të jetë bërë miratimi me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.
2. Nuk mund të zgjidhen në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës, Administratorët e Shoqërisë dhe të shoqërive të të njëjtit grup apo personat e lidhur me ta në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit 13, të Ligjit. Kufizime të tjera në lidhje me mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës parashikohen në nenin 156,



- të Ligjit.
3. Shumica e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës duhet të jenë të pavarur sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 4, të nenit 155, të Ligjit.
 4. Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një person i cili dëshiron të ushtrojë detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës për të plotësuar një vend të lirë ose si një anëtar tjetër shtesë, me kusht që të mos tejkalohet numri i anëtarëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Kohëzgjatja në detyrë e anëtarit të emëruar në këtë mënyrë është deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme

Neni 12

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

1. Këshilli Mbikqyrës nuk merr pjesë në administrimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës vëzhgon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët dhe kontrollon pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e Ligjit dhe të Statutit. Detyrat e Këshillit Mbikqyrës të përcaktuara, në shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1, pikës 2, të nenit 154 dhe pikës 1, të nenit 167, të Ligjit, nuk mund t'iu delegohen administratorëve.
2. Këshilli Mbikqyrës ka edhe këto kompetenca:
3. Propozon përpara Asamblesë së Përgjithshme Administratorët dhe Ekspertët Kontabël të Autorizuar;
4. Bazuar në shkronjën "e", të pikës 1, të nenit 154, të Ligjit, harton raportin vjetor mbi ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë dhe ia paraqet Asamblesë së Përgjithshme sipas pikës 3, të nenit 13, të Ligjit;
5. Harton raportin vjetor për drejtimin e brendshëm të shoqërisë, si dhe kualifikimin e Administratorëve dhe Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës duke e publikuar këtë raport sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 134, të Ligjit;
6. Asnjë ndryshim, i mëvonshëm i Statutit apo i udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Këshillit Mbikqyrës, nëse këto të fundit do të ishin të vlefshme në rast se nuk do të ishin ndryshuar.

Neni 13

Përfundimi i marrëdhënies së Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Marrëdhënia e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës përfundon në rastet si më poshtë:

1. Personi nuk është më Anëtar i Këshillit Mbikqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë parashikimet, sipas të nenit 157 dhe pikës 4, të nenit 167, të Ligjit;
2. Personi ndodhet në gjendje paaftësie pague;e;
3. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
5. Ka munguar për një periudhë kohore më të gjatë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikqyrës, në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe për këtë arsye Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Këshillit Mbikqyrës, ka vendosur shkarkimin e tij;

Neni 14

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave

ASHKIA GJITHSHME

- të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi frekuencën e zhvillimit të këtyre mbledhjeve.
- Vendimet e Këshillit Mbikqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 dhe të pikës 5, të nenit 167, të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtar në momentin e emërimit.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari drejton çdo takim të Këshillit Mbikqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për zhvillimin e mbledhjes, anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.
 4. Rendi i ditës miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Në rastet kur numri i votave është i barabartë vota e Kryetarit konsiderohet si vendimtare.
 5. Të gjitha aktet e miratuara nga mbledhja e Këshillit Mbikqyrës ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin të legjitimuar për të vazhduar detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës, duke pasur të drejtë për të votuar në mbledhje.
 6. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës është njësoj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

Neni 15.

Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk do të lidhin marrëveshje me subjekte juridik apo fizik, si dhe nuk do të votojnë për çështje në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës, nëse kanë direkt ose indirekt, një interes apo detyrim material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, sipas nenit 13 të Ligjit, deri në momentin kur të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës në mënyrë unanime vendosin që:
2. Të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes përkatëse;
3. Të autorizojnë anëtarin që i nënshtrohet kufizimeve, për të votuar për çështjen përkatëse;
4. Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar dhe për çdo rast zbatohen parashikimet e pikave 2 dhe 5, të nenit 13, të Ligjit.
5. Vota e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.
6. Në rast se në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtar të tij, çështja mund t'i drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit Mbikqyrës të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 16

Procesverbalet e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës merr të gjitha masat që në libra të veçantë të mbahen procesverbalet në lidhje me:

3. Të gjithë takimet të kryera nga Këshilli Mbikqyrës;
4. Të gjithë mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, përfshirë edhe emrat e të gjithë administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje;

Neni 17

Shpërblimet për Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorët

1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorët përfitojnë shpërblim në masën dhe kohën e përcaktuar në skemën miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 160, të Ligjit.
2. Përfitimet individuale përcaktohen nga Këshilli Mbikqyrës dhe ato duhet të pasqyrojnë përgjegjësitë e Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni dhe të gjendjes financiare të Shoqërisë.
3. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë shpërndarjen e shpërblimeve në të holla, pensione, sigurime ose të ardhura të tjera për personat që kanë kryer më parë detyrën e administratorëve ose anëtarëve të Këshillit Drejtues në këtë shoqëri apo në shoqëri të tjera që rrjedhin apo janë bërë pjesë përbërëse e shoqërive të reja
4. Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Drejtues mund të përfitojnë rimbursimin e të gjithë shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit ose të shpenzimeve të tjera që kanë lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre funksionale në funksion të Shoqërisë.

Neni 18

Hetimet e posaçme dhe mbikqyrja

Çdo person ose grup personash, që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit, ose për të kërkuar nga Këshilli Mbikqyrës që të kryejë detyrat e tij në rastet e veçanta të parashikuara në nenin 165 dhe në pikën 2, të nenit 166, të Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar, me anë të të cilit vërtetohet se personi ose grupi i personave plotësojnë kushtet për të kryer këtë veprim.

Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 19

Shpërndarja e dividendëve

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe në bazë të miratimit me shumicë të zakonshme të votave të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria shpërndan dividendë, proporcionalisht me të drejtat e zotërimit të aksioneve të shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen, në përputhje me kapitalin fillestar të likujduar për zotërimin e aksioneve për të cilët shpërndahet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me vlerën e kapitalit fillestar të likujduar, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhen dividendi.

Në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

4. Çdo shumë dividendi që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme përfitohet nga Shoqëria, që në vijim nuk është më e detyruar që t'a paguajë atë.

Neni 20

Kalim i i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali, pasi ky kalim të jetë miratuar paraprakisht nga Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar të votave.

Kreu V

Prishja e shoqërtisë dhe njoftimet

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionerëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë.

Për të realizuar shpërndarjen e pasurisë sipas pikës 1 të këtij neni, likuiduesi mund të vlerësojë cdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zatërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Neni 22

Njoftimet

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në pikën 3, të nenit 4, të këtij Statuti janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
2. Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit ose në adresën apo postën elektronike e cila i është njoftuar shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksionari, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.
3. Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjithë dokumentat, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohen nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipa parashikimeve të pikës 2 të nenit përkatës të këtij Statuti

Neni 23

Emërimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar

Ekspertë Kontabël të Autorizuar të emëruar nga Asambleja e Aksionerëve janë:

- z.Luan Muça dhe z.Niko Mijo.

BASHKIA GJIROK

Neni 24
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë përbëhet nga zotëruesi i 100% të aksioneve të saj që është Bashkia Gjirokastrë e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë. Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që nuk janë parashikuar në këtë statut, ushtrohen nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë.

Neni 25
Dispozita e fundit

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Aksionari i vetëm
KRYETARI I BASHKISË GJIROKASTËR
FLAMIR SOLEMI



Nr. 1253rd.
Dt. 02.07.2020.
G.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE
SEKTORI I REGJISTRIMIT

Nr. 11809 prot

Tiranë, më 25/06.2020

Lënda: Për rregullimin në QKB të informacionit mbi pronësinë.

TRAJTIMI I STUDENTEVE SH A GJIROKASTËR
Nipt K43128662E
LAGJA 18 SHTATORI
GJIROKASTËR

Për dijeni: Qendrës Kombëtare të Biznesit

Nga të dhëna që administrojmë dhe verifikimeve të kryera Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se gjatë procesit të regjistrimit apo përditësimit të informacionit të kryer nga ana Juaj, tek të dhënat e pronësisë keni deklaruar pronësinë “shqiptare” dhe jo pronësinë reale “shqiptare shtetërore”.

Bazuar sa më sipër, e dhëna mbi pronësinë e subjektit/ndërmarjes Tuaj duhet të jetë “shqiptare shtetërore”, prandaj lutemi të paraqiteni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në zyrën më të afërt rajonale të saj, për të bërë sistemimin përkatës të pronësisë që Ju duhet të keni realisht.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Delina Ibrahimaj

